FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 3	2003	Shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 49, datë 23.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve……	75
Vendim i KM nr. 50, datë 23.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës, për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar……	81
Vendim i KM nr. 51, datë 23.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve…..……	84
Vendim i KM nr. 52, datë 23.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit……..…	90
Vendim i KM nr. 53, datë 23.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, për bashkëpunimin në fushën e turizmit…….	92

Vendim i KM nr. 59, datë 23.1.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr. 415, datë 1.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e komitetit "Për mundësi të barabarta", ndryshuar me vendimin nr.127, datë 15.3.2001……	95
Vendim i KM nr. 60, datë 23.1.2003	Për disa ndryshime dhe një shtesë në vendimin nr. 372, datë 25.7.1994 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e mallrave rezervë shtetërore"…….……	96
Vendim i KM nr. 61, datë 23.1.2003	Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës……	97
Vendim i KM nr. 62, datë 23.1.2003	Për një ndryshim në vendimin nr. 402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"", ndryshuar me vendimin nr. 458, datë 28.6.2001 të Këshillit të Ministrave……..…	99
Vendim i KM nr. 63, datë 23.1.2003	Për numrin e punonjësve, strukturën dhe organikën e Shërbimit të Gjendjes Civile në njësitë e qeverisjes vendore……	99
Vendim i KM nr. 64, datë 23.1.2003	Për përcaktimin e numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, në këshillat e qarqeve, dhe të zyrave të menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës, në komuna dhe/ose bashki ……	113
Vendim i KKRT nr. 131, datë 29.1.2003	Mbi heqjen dhe reduktimin e kohës së vlefshmërisë të licencave për disa subjekte televizive……	115

V E N D I M
Nr. 49, datë 23.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË UKRAINËS, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË UKRAINËS

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Ukrainës (Kabineti i Ministrit), këtu më poshtë të referuara si "Palë":

Duke dëshiruar të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik për përfitimin reciprok të të dy vendeve;

Duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës Palë në territorin e Palës tjetër; dhe

Duke njohur se nxitja dhe mbrojtja e investimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të stimulojë nismat investuese në këtë fushë,

ranë dakord si vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi "Investitor" kupton në lidhje me secilën Palë:

a) personin fizik i cili, në përputhje me ligjet e kësaj Pale, konsiderohet si shtetas i saj;

b) entet ligjore, duke përfshirë shoqëritë, shoqatat, shoqëritë e përbashkëta, korporatat, filialet dhe çdo lloj organizimi të inkorporuar ose të krijuar ose me fjalë të tjera të organizuar në përputhje me ligjin e kësaj Pale.

2. Termi "Investim" kupton çdo lloj pasurie dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, si më poshtë:

a) pjesëmarrjen me aksione, detyrimet e një shoqërie dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në një shoqëri që ka një vlerë ekonomike, duke përfshirë çdo kredi të dhënë me qëllim krijimin e një vlere ekonomike.

b) pasurinë e tundshme dhe të patundshme si dhe çdo të drejtë tjetër, si hipotekat, qiratë, uzufrukti, pengjet dhe të drejta të ngjashme;

c) të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale si patentat, licencat, markat tregtare, emrat tregtarë, sekretet tregtare si dhe proceset teknike, know-how dhe dëshira e mirë;

d) të drejtat për të ndërmarrë veprimtari ekonomike dhe tregtare në bazë të ligjit ose në sajë të një kontrate, duke përfshirë koncesionet për studimin, kërkimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Çdo ndryshim në formën në të cilën pasuritë janë investuar ose riinvestuar nuk do të prekin

karakterin e tyre si investim, në rast se ky ndryshim është kryer në përputhje me ligjet dhe rregullat e Palës pritëse të investimit.

3. Termi "të ardhura" kupton shumat e vjela nga një investim dhe përfshin në veçanti, por jo eksluzivisht, fitimet, dividentet, interesat, rritjen e kapitalit, shpërblime dhe të ardhura në forma të tjera.

4. Termi "territor" përcakton tërësinë tokësore dhe ujore të secilës Palë, si dhe zonën ekonomike ekskluzivisht dhe shellfin kontinental jashtë kufijve të ujërave territoriale të secilës Palë, mbi të cilat ata ushtrojnë ose mund të ushtrojnë të drejtat e sovranitetit dhe juridiksionit me qëllim shfrytëzimin, zbulimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 2
Nxitja dhe pranimi

1. Çdo Palë do të nxisë dhe do të krijojë kushte të favorshme për investitorët e Palës tjetër, për të bërë investime në territor dhe do t'i pranojë këto investime në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e saj.

2. Me qëllim që të inkurajohet reciprokisht fluksi i investimeve, çdo Palë merr përsipër të informojë Palën tjetër, me kërkesën e kësaj të fundit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit të tij, për mundësitë investuese në territorin e saj.

3. Kur një Palë ka pranuar një investim në territorin e saj, ajo do t'i japë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj, lejet e nevojshme që janë të lidhura me këtë investim dhe kryerjen e marrëveshjeve të licencimit dhe kontratave për asistencë teknike, tregtare ose administrative. Çdo Palë është e detyruar të lëshojë, nëse kërkohet, autorizimet e nevojshme në lidhje me aktivitetin e konsultimit dhe persona të tjerë të kualifikuar, pavarësisht nga kombësia e tyre.

4. Kjo Marrëveshje do të zbatohet gjithashtu për investimet e kryera përpara hyrjes në fuqi të saj, nga investitorët e njërës Palë në territorin e Palës tjetër.

Neni 3
Mbrojtja

1. Investimeve të bëra nga investitorët e njërës Palë në territorin e Palës tjetër, në çdo kohë do t'u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë. Në asnjë rast, një Palë nuk do t'u japë këtyre investimeve trajtim më pak të favorshëm sesa ai i kërkuar nga e drejta ndërkombëtare.

2. Asnjëra Palë nuk do të pengojë në asnjë mënyrë, nëpërmjet masash arbitrare ose diskriminuese, operimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, shitjen dhe nëse është rasti edhe likujdimin e këtij investimi. Çdo Palë do të vëzhgojë çdo detyrim që ka të bëjë me investimet e investitorëve të Palës tjetër.

Neni 4
Trajtimi kombëtar dhe i kombit më të favorizuar

1. Çdo Palë do t'u japë në territorin e saj, investimeve ose të ardhurave të investitorëve të Palës tjetër, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo i ka dhënë investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të një shteti të tretë, cilido është më i favorshëm për investitorin në fjalë.

2. Ky trajtim nuk do të shtrihet tek privilegjet, të cilat secila Palë mund t'ju japë investitorëve të një shteti të tretë për shkak të anëtarësimit të tyre ose përfshirjes në ndonjë zonë të tregtisë së lirë, bashkimi doganor, tregu të përbashkët ose ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të ngjashme, ekzistuese ose që do të krijohet në të ardhmen tek të cilat cilado prej Palëve është ose mund të bëhet Palë.

3. Çdo Palë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e veta do t'ju japë investimeve ose të ardhurave të investitorëve të Palës tjetër një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i dhënë investimeve ose të ardhurave të investitorëve të vet.

4. Trajtimi i dhënë në këtë nen nuk do të konsiderohet si detyrim për një Palë, që të shtrijë tek investitorët e Palës tjetër përfitimet e çdo trajtimi, preference ose privilegji që rezulton nga ndonjë

marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin, përfshirë çdo marrëveshje për evitimin e taksimit të dyfishtë, ose çdo ligj kombëtar që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin.

Neni 5
Shpronësimi

1. Investimet ose të ardhurat e investitorëve të secilës prej Palëve në territorin e Palës tjetër nuk do të shpronësohen, shtetëzohen ose nuk do të jenë subjekt i ndonjë mase tjetër që ka efekt ekuivalent me atë të shpronësimit ose të shtetëzimit (këtu më poshtë referuar si "shpronësim") me përjashtim kur kërkohet për interes publik, mbështetur në ligj, mbi baza jo diskriminuese dhe kundrejt një pagese të menjëhershme të përshtatshme dhe një kompensimi efektiv.

2. Ky kompensim do të llogaritet me vlerën reale të tregut të investimit të shpronësuar, në momentin përpara se masa e shpronësimit të kryhet ose përpara se ky shpronësim të bëhet publikisht i njohur, cilido është më i hershmi. Kompensimi do të përfshijë interesat e zakonshme tregtare deri në datën e pagesës, do të paguhet pa vonesë, në një monedhë lirisht të konvertueshme dhe do të jetë efektivisht i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm.

3. Investitori i prekur, gëzon të drejtën, sipas ligjit të Palës që bën shpronësimin, për një shqyrtim të menjëhershëm nga ana e autoriteteve gjyqësore ose kompetente dhe të pavarura të kësaj Pale, të rastit të tij dhe të përcaktojë nëse ky shpronësim dhe vlerësimi i investimit të tij është në përputhje me parimet e vendosura në këtë nen.

4. Kur një Palë shpronëson pasuritë e një shoqërie, e cila është krijuar ose themeluar sipas ligjit në fuqi në çdo pjesë të territorit të saj, dhe në të cilën investitorët e Palës tjetër zotërojnë aksione, ajo do të sigurojë që dispozitat e këtij neni të zbatohen si garanci për një kompensim të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv në lidhje me investimin e tyre ku investitorët e Palës tjetër janë zotërues të këtyre aksioneve.

Neni 6
Kompensimi për humbjet

Investitorët e një Pale, investimet apo të ardhurat e të cilëve pësojnë humbje në territorin e Palës tjetër për shkak të konfliktit të armatosur, revolucionit, gjendjes së emergjencës kombëtare, kryengritjeve, luftës civile ose ngjarjeve të ngjashme, do t'u jepet nga kjo Palë në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin ose ndonjë zgjidhje tjetër të vlefshme, një trajtim jo më pak i favorshëm sesa kjo Palë i jep investitorëve të vet ose të një shteti të tretë cilido qoftë më i favorshmi prej tyre për investitorin. Pagesat e rezultuara do të jenë lirisht të transferueshme.

Pavarësisht nga paragrafi 1, një investitori të një Pale, i cili, në secilën nga situatat e referuara në këtë paragraf, pëson humbje në territorin e Palës tjetër që rezultojnë nga:

a) konfiskimi i investimit ose i një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e kësaj të fundit;

b) shkatërrimi i investimit ose i një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e kësaj të fundit, që nuk ishte i nevojshëm për situatën, do t'i jepet nga Pala e fundit dëmshpërblimi ose kompensimi i cili në çdo rast do të jetë i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv. Pagesat e rezultuara do të bëhen pa vonesë në monedhë lirisht të konvertueshme dhe lirisht të transferueshme.

Neni 7
Transferimet

1. Çdo Palë do t'ju garantojë investitorëve të Palës tjetër transferimin e lirë të të gjitha pagesave që kanë të bëjnë me investimet e tyre. Këto transferime do të përfshijnë në veçanti, por jo ekskluzivisht:

(a) kapitalin fillestar dhe çdo shtesë në kapital për mirëmbajtjen ose rritjen e një investimi sipas legjislacionit në fuqi të secilës Palë;

(b) të ardhura nga investimi, të përcaktuara në nenin 1;

(c) fondet për shlyerjen e huave në lidhje me një investim;

(d) kompensimet që jepen në bazë të neneve 5 dhe 6;

(e) të ardhurat dhe shpërblimet e personelit të angazhuar nga jashtë në lidhje me një investim;

(f) pagesat që kryhen në bazë të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje.

2. Pala pritëse e një investimi do t'i lejojë investitorëve të Palës tjetër, që të kenë akses në tregun e shkëmbimeve valutore në një mënyrë jo diskriminuese kështu që investitori mund të blejë valutën e nevojshme me qëllim që të bëjë transferimin në bazë të këtij neni.

3. Transferimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhen pa vonesë dhe në një monedhë lirisht të transferueshme me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transferimit.

4. Palët marrin përsipër që të lehtësojnë procedurat e nevojshme që nevojiten për të kryer transferimin pa vonesë. Në veçanti, nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj nga data në të cilën investitori do të paraqesë aplikimin e nevojshëm për transferim deri në datën që transferimi të kryhet aktualisht.

5. Palët do t'u japin transferimeve që referohen në këtë nen një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që i është dhënë transferimit të pagesave që kryhen nga invesitorët e ndonjë shteti të tretë.

Neni 8

Kushtet më favorizuese

1. Nëse legjislacioni i ndonjërës prej Palëve ose detyrimeve që rrjedhin sipas të drejtës ndërkombëtare ekzistuese ose të vendosur më vonë midis Palëve si plotësim i kësaj Marrëveshjeje, përmbajnë rregullime, qofshin këto të përgjithshme apo të veçanta, që u japin investitorëve të Palës tjetër një trajtim më të favorshëm sesa ai i dhënë nga kjo Marrëveshje, ky rregullim do të jetë mbizotërues për aq sa ai është më i favorshëm kundrejt kësaj Marrëveshjeje.

2. Kushtet më favorizuese se këto të kësaj Marrëveshjeje të cilat janë pranuar prej njërës prej Palëve me investitorët e Palës tjetër nuk do të preken nga kjo Marrëveshje.

Neni 9

Subrogimi

Nëse një Palë ose Agjencia e përcaktuar prej saj bën një pagesë për një zhdëmtim, garanci ose kontratë sigurimi kundrejt një risku jotregtar në lidhje me një investim të bërë nga ndonjë prej investitorëve të saj në territorin e Palës tjetër, Pala e fundit do të njohë kalimin e çdo të drejte apo detyrimi të këtij investitori tek ish Pala ose Agjencia e përcaktuar prej saj, që të ushtrojë në bazë të zëvendësimit me të drejta të plota, çdo të drejtë në të njëjtën masë sa edhe paraardhësi i tij. Ky zëvendësim me të drejta të plota do të bëjë të mundur që ish Pala apo Agjencia e përcaktuar prej saj të jetë direkt përfituese e çdo pagese për dëmshpërblim apo kompensim tjetër që mund të ngarkohet të kryejë investitori.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis Palëve

1. Çdo mosmarrëveshje midis Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për sa është e mundur, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk është e mundur të zgjidhet brenda gjashtë (6) muajve prej fillimit të bisedimeve, ajo do t'i nënshtrohet me kërkesën e njërës prej Palëve një gjykate arbitrazhi.

3. Gjykata e arbitrazhit do të krijohet në mënyrën e mëposhtme: çdo Palë do të emërojë një gjykatës dhe këta dy gjykatës do të zgjedhin shtetasin e një shteti të tretë si president. Gjykatësit do të zgjidhen brenda tre muajve dhe kryetari brenda pesë muajve, nga data kur secila Palë njofton tjetrën për dëshirën e saj që t'ja nënshtrojë mosmarrëveshjen një gjykate arbitrazhi.

4. Në rast se brenda afateve të specifikuara në paragrafin (3) të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila Palë, në mungesë të ndonjë Marrëveshjeje tjetër, mund të ftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Presidenti është shtetas i ndonjërës prej Palëve, ose në qoftë se ai ndalohet të kryejë funksionet e mësipërme, Zëvendëspresidenti ftohet që të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Zëvendëspresidenti gjithashtu është shtetas i njërës prej Palëve ose nëse ai ndalohet të kryejë funksionet e mësipërme, anëtari më i vjetër i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i cili nuk është shtetas i njërës prej Palëve

do të ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Gjykata do t'i nxjerrë vendimet e saj në bazë të respektimit të rregullave që përmban kjo Marrëveshje ose të marrëveshjeve të tjera në fuqi midis Palëve si dhe parimeve universale të së drejtës ndërkombëtare.

6. Gjykata i përcakton vetë procedurat, përveçse kur Palët vendosin ndryshe.

7. Gjykata e arbitrazhit do t'i marrë vendimet me shumicë votash dhe ky vendim do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët.

8. Çdo Palë do të përballojë shpenzimet për gjykatësin e zgjedhur prej tij dhe ato të përfaqësimit në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e tjera përfshirë dhe ato të kryetarit do të përballohen në pjesë të barabarta nga të dyja Palët.

Neni 11

Mosmarrëveshjet midis njërës Palë dhe një Investitori

1. Mosmarrëveshjet që mund të ngrihen midis njërës Palë dhe një Investitori të Palës tjetër në lidhje me një investim sipas kuptimit të kësaj Marrëveshjeje, do të paraqiten me shkrim, përfshirë dhe një informacion të detajuar, nga investitori tek Pala pritëse e investimit. Për sa të jetë e mundur, palët e interesuara do të përpiqen ta zgjidhin këtë mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

2. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda gjashtë muajve nga data kur njoftimi me shkrim referuar paragrafit 1 është shtruar për zgjidhje, mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet, sipas zgjedhjes së investitorit:

a) gjykatës kompetente të Palës në territorin e së cilës investimi është kryer;

b) një gjykate të përkohshme të krijuar sipas rregullave të arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Tregtar Ndërkombëtar;

c) Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) të krijuar nga "Konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera", e hapur për nënshkrim në Washington D.C., në 18 mars 1965, në rastin kur të dy Palët janë anëtare të kësaj Konvente. Për aq kohë sa njëra Palë e cila është Palë në mosmarrëveshje nuk është bërë Shtet i Konventës së përmendur më sipër, mosmarrëveshja do të trajtohet në përputhje me dispozitat shtesë për administrimin e procedurave nga Sekretariati i Qendrës.

3. Arbitrimi do të bazohet në:

- dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe të marrëveshjeve të tjera në fuqi midis Palëve;
- rregullat dhe parimet universale të së drejtës ndërkombëtare;
- ligji kombëtar i Palës në territorin e së cilës është bërë investimi, përfshi rregullat në lidhje me konfliktet në ligj.

4. Një Palë do të shfrytëzojë për mbrojtje, dëmshpërblimin ose kompensimin për të gjithë ose një pjesë të dëmit të pësuar, që është marrë ose do të merret nga investitori në bazë të një kontrate garancie ose sigurimi.

5. Vendimi do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët në mosmarrëveshje. Secila Palë merr përsipër që të zbatojë vendimet në përputhje me legjislacionin e vendit të tij.

Neni 12

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët do të njoftojnë njëra- tjetrën se formalitetet kushtetuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare janë përfunduar. Ajo do të jetë në fuqi për një periudhë dhjetë vjeçare, dhe do të rinovohet, në mënyrë të heshtur, për një periudhë dy vjeçare në vazhdim.

2. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje me një njoftim me shkrim, gjashtë muaj përpara datës së përfundimit të saj.

Për investimet e bëra para datës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e të gjitha neneve të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi për një periudhë të mëtejshme prej dhjetë vjetësh nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Dëshmojmë se kjo Marrëveshje është nënshkruar me plotfuqishmëri respektive.

Bërë në Tiranë, më 25 tetor 2002 në dy origjinale në gjuhët shqip, ukrainase dhe anglisht

duke qenë të gjitha tekstet me fuqi të barabartë.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

V E N D I M
Nr. 50, datë 23.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË UKRAINËS, PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE TREGTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës, për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.

Ky vendim në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË UKRAINËS MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK DHE TREGTAR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Ukrainës (Kabineti i Ministrit), të cilësuara këtu më poshtë "Palë":

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare midis Palëve;

Të shtyrë nga vullneti i përbashkët për zhvillimin e marrëdhënieve me interes të përbashkët dhe mirëkuptimit;

Duke kuptuar nevojën e adaptimit të praktikave standarde të tregut ndërkombëtar dhe zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë aktivisht për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, në përputhje me ligjet dhe rregullat e tyre përkatëse, të drejtat e ligjit ndërkombëtar, në bazë të përfitimit të dyanshëm dhe të barabartë dhe të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Palët do t'i japin njëri-tjetrit trajtimin e kombit më të favorizuar, lidhur me të gjitha çështjet e eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vendet respektive të Palëve, në përputhje me principet e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT), Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime (GATS) dhe Marrëveshjen themeltare të Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO).

Dispozitat e këtij neni, megjithatë, nuk do të aplikohen ndaj avantazheve dhe privilegjeve të siguruara ose për t'u siguruar prej çdo Pale:

në favor të vendeve fqinje me qëllim lehtësimin e zhvillimit të tregtisë kufitare;

në favor të vendeve me të cilët çdo Palë ka përfunduar ose do të përfundojë në të ardhmen, një Marrëveshje mbi unifikimin e doganave ose mbi krijimin e zonave të tregtisë së lirë.

Neni 3

Palët do të nxisin zhvillimin e tregtisë sikurse dhe prodhimin, investimet dhe lloje të tjera të bashkëpunimit ekonomik në fusha të tilla si inxhinieria energjetike, inxhinieritë, industritë kimike dhe metalurgjike, prodhimi i mallrave të konsumit, kërkimi dhe përdorimi i burimeve natyrore, transporti, telekomunikacioni, industria e ndërtimit, informatika, bujqësia, industria e ushqimit, turizmi, shërbimet dhe fusha të tjera me interes të përbashkët.

Neni 4

Eksporti dhe importi i mallrave dhe i shërbimeve sikurse dhe bashkëpunimi ekonomik midis Palëve, do të realizohen në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve të tjera të realizuara në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, të vendeve respektive të Palëve, midis personave juridikë dhe fizikë të çdo Pale.

Neni 5

Palët do të përkrahin zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta midis tyre, nëpërmjet nxitjes dhe mbrojtjes reciproke të investimeve, parandalimit të taksimeve dyfishe dhe masave të tjera të pranuara prej tyre.

Neni 6

Palët do të nxisin:

- kontaktet dhe zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik midis personave juridikë dhe fizikë të çdo Pale;
- pjesëmarrjen e personave juridikë dhe fizikë të çdo Pale, në ekspozitat dhe panairet e organizuara prej tyre, shkëmbimin e delegacioneve të ekspertëve në fushat e ekonomisë dhe tregtisë, shkëmbimin e informacionit veçanërisht në lidhje me ndryshimet legjislative, programet ekonomike qeveritare dhe format e tjera të kontratave të punës, duke kontribuar në bashkëpunimin midis tyre.

Neni 7

Në marrëdhëniet e tyre të përbashkëta në fushën financiare, bankare dhe të sigurimeve, Palët do të aplikojnë principet e Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime (GATS) dhe do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendet e tyre përkatëse.

Neni 8

Pagesat midis personave juridikë dhe fizikë të Palëve, do të realizohen në monedhë lirisht të konvertueshme në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në territoret respektive të çdo Pale.

Nga pikëpamja e rritjes së shkëmbimit të mallrave dhe zgjerimit të gamës së artikujve, personat juridikë dhe fizikë të çdo Pale, mund të ndjekin gjithashtu forma të tjera të veprimit tregtar duke përfshirë kompensimin ose shkëmbimin.

Neni 9

Çdo Palë, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendin e saj, do të sigurojë të gjitha lehtësirat e mundshme për shkarkimin, magazinimin e përkohshëm dhe transitimin e mallrave të Palës tjetër.

Neni 10

Për përmbushjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të ngrenë një Komision të

përbashkët, i cili do të përbëhet nga përfaqësues prej çdo Pale.

Komisioni i përbashkët do të:

- rishikojë ecurinë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe propozojë masa për zgjidhjen e vështirësive të hasura në marrëdhëniet ekonomike të përbashkëta;

- gjejë mundësi të tjera për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtisë.

Komisioni i përbashkët do të mblidhet një herë në vit, alternativisht në Ukrainë dhe në Republikën e Shqipërisë, në datën e caktuar bashkërisht.

Neni 11

Çdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit formal e reciprok të Palëve, e cila realizohet me protokoll të veçantë që është një pjesë thelbësore e kësaj Marrëveshjeje.

Çdo Palë duhet t'i përgjigjet propozimeve për rregullim ose ndryshim të bëra prej Palës tjetër, jo më vonë se 60 ditë pas marrjes së këtij propozimi.

Neni 12

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e shkëmbimit të njoftimeve dëshmuese për përmbushjen e procedurave ligjore përkatëse prej të dy vendeve.

Kjo Marrëveshje do të mbesë në fuqi për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh e do të shtyhet atutomatikisht për një periudhë prej 1 (një) viti, nëse çdonjëra prej Palëve, nuk njofton me shkrim Palën tjetër, mbi dëshirën për t'i dhënë fund Marrëveshjes, së paku (tre) muaj para datës së shfuqizimit të saj.

Bërë në Tiranë, më 25 tetor 2002 në dy origjinale në gjuhët shqip, ukrainase dhe anglisht në tekste njëlloj autentike.

Në rast kontradikte në interpretim, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

V E N D I M
Nr. 51, datë 23.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Jugosllavisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË

FEDERALE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federale e Republikës Federale të Jugosllavisë, këtu më poshtë të referuara si "Palë":

Duke dëshiruar të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik për përfitimin reciprok të të dy vendeve;

Duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës Palë në territorin e Palës tjetër;

Duke njohur se nxitja dhe mbrojtja e investimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të stimulojë iniciativat investuese në këtë fushë.

Ranë dakord si vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

Termi "Investitor" kupton:

a) personat fizikë të cilët, në përputhje me ligjet e kësaj Pale, konsiderohen si shtetas të saj dhe janë duke bërë investime në territorin e Palës tjetër.

b) personat juridik, duke përfshirë shoqëritë, shoqatat, shoqëritë e përbashkëta, korporatat, filialet dhe çdo lloj tjetër organizimi të inkorporuar ose të krijuar ose me fjalë të tjera të organizuar në përputhje me ligjin dhe rregullat e Palës ku janë të vendosura këto persona juridikë.

2. Termi "Investim" kupton çdo lloj pasurie dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, si më poshtë:

a) pjesëmarrjen me aksione, detyrimet e një shoqërie dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në një shoqëri;

b) pretendimet në para ose të çdo forme tjetër në bazë të një kontrate që ka vlerë ekonomike lidhur me një investim;

c) pasurinë e tundshme dhe të patundshme si dhe çdo të drejtë tjetër, si hipotekat, qiratë, uzufrukti, pengjet dhe të drejta të ngjashme;

d) të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale si patentat, licencat, markat tregtare, emrat tregtarë, si dhe proceset teknike, know-how, dhe dëshira e mirë;

e) të drejtat për të ndërmarrë veprimtari ekonomike dhe tregtare në bazë të ligjit ose në sajë të një kontrate, duke përfshirë koncensionet për kërkimin, kultivimin, nxjerrjen ose shfrytëzimin e burimeve natyrore;

Çdo ndryshim në formën në të cilën pasuritë janë investuar ose riinvestuar nuk do të prekin karakterin e tyre si investim, në rast se ky ndryshim është kryer në përputhje me ligjet dhe rregullat e Palës pritëse të investimit.

3. Termi "të ardhura" kupton shumat e vjela nga një investim, dhe përfshin në veçanti, por jo ekskluzivisht, fitimin, dividentet, interesin, rritjen e kapitalit, shpërblime dhe të ardhura të tjera.

4. Termi "territor" kupton:

- lidhur me Republikën e Shqipërisë: Territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë përfshirë ujërat territoriale e shellfin kontinental mbi të cilat Republika e Shqipërisë në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj kombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare, ushtron të drejtat e saj sovrane e ligjore; dhe

- lidhur me Republikën Federale të Jugosllavisë: Tërësinë e kufijve tokësorë dhe ujorë, bregdetin dhe nëntokën e tij jashtë territorit ujor mbi të cilat Republika Federale e Jugosllavisë në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare ushtron të drejtën sovrane dhe ligjore.

Neni 2
Nxitja dhe pranimi

1. Çdo Palë do të nxisë dhe do të krijojë kushte të favorshme për investitorët e Palës tjetër, për

të bërë investime në territorin e saj dhe do t'i pranojë këto investime në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e saj.

2. Kur një Palë ka pranuar një investim në territorin e saj, ajo do t'i japë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj, lejet e nevojshme që janë të lidhura me këtë investim dhe kryerjen e marrëveshjeve të licencimit dhe kontratave për asistencë teknike, tregtare ose administrative.

Neni 3
Mbrojtja

1. Investimeve të bëra nga investitorët e njërës Palë në territorin e Palës tjetër, në çdo kohë do t'u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë ligjore. Në asnjë rast një Palë nuk do t'u japë këtyre investimeve trajtim më pak të favorshëm sesa ai i kërkuar nga e drejta ndërkombëtare.

2. Asnjëra Palë nuk do të pengojë në asnjë mënyrë, nëpërmjet masash arbitrare ose diskriminuese, operimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, shitjen dhe nëse është rasti edhe likuidimin e këtyre investimeve. Çdo Palë do të vëzhgojë çdo detyrim që ka të bëjë me investimet e investitorëve të Palës tjetër.

Neni 4
Trajtimi kombëtar dhe i kombit më të favorizuar

1. Çdo Palë do t'ju japë në territorin e saj, investimeve ose të ardhurave të investitorëve të Palës tjetër, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo i ka dhënë investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të një shteti të tretë, cilido është më i favorshëm për investitorin në fjalë.

2. Ky trajtim nuk do të shtrihet tek privilegjet të cilat secila Palë mund t'ju japë investitorëve të një shteti të tretë, për shkak të anëtarësimit të tyre ose përfshirjes në ndonjë zonë të tregtisë së lirë, bashkimi doganor, tregu të përbashkët ose ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të ngjashme, ekzistuese ose që do të krijohet në të ardhmen, tek të cilat cilado prej Palëve është ose mund të bëhet Palë.

3. Çdo Palë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e veta, do t'ju japë investimeve ose të ardhurave e investitorëve të Palës tjetër, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i dhënë investimeve ose të ardhurave të investitorëve të vet.

4. Trajtimi i dhënë në këtë nen nuk do të konsiderohet si detyrim për një Palë që të shtrijë tek investitorët e Palës tjetër përfitimet e çdo trajtimi, preference ose privilegji që rezulton nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin, përfshirë çdo marrëveshje për evitimin e taksimit të dyfishtë, ose çdo ligj kombëtar që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin.

Neni 5
Shpronësimi

1. Invesitmet ose të ardhurat e investitorëve të secilës prej Palëve në territorin e Palës tjetër nuk do të shpronësohen, shtetëzohen ose nuk do të jenë subjekt i ndonjë mase tjetër që ka efekt ekuivalent me atë të shpronësimit, ose të shtetëzimit (këtu më poshtë referuar si "shpronësim"), me përjashtim kur kërkohet për interes publik, mbështetur në ligj, mbi baza jodiskriminuese dhe kundrejt një pagese të menjëhershme të përshtatshme dhe një kompensimi efektiv.

2. Ky kompensim do të llogaritet me vlerën e tregut të investimit të shpronësuar, në momentin përpara se masa e shpronësimit të kryhet, ose përpara se ky shpronësim të bëhet publikisht i njohur, cilido është më i hershmi. Kompensimi do të përfshijë interesin e zakonshëm tregtar deri në datën e pagesës, do të paguhet pa vonesë, në një monedhë lirisht të konvertueshme dhe do të jetë efektivisht i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm.

3. Investitori i prekur, gëzon të drejtën, sipas ligjit dhe rregullave të Palës që bën shpronësimin, për një shqyrtim të menjëhershëm nga ana e autoriteteve gjyqësore ose kompetente dhe të pavarura të kësaj Pale, të rastit të tij dhe të përcaktojë nëse ky shpronësim dhe vlerësimi i investimit të tij është në përputhje me parimet e vendosura në këtë nen.

Neni 6
Kompensimi për humbjet

1. Investitorët e një Pale, investimet ose të ardhurat e të cilëve pësojnë humbje në territorin e Palës tjetër për shkak të konfliktit të armatosur, revolucionit, gjendjes së emergjencës kombëtare, revoltës, kryengritjeve, luftës civile ose ngjarjeve të ngjashme, do t'u jepet nga Pala e fundit në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin ose ndonjë zgjidhje tjetër të vlefshme, një trajtim jo më pak i favorshëm sesa kjo Palë i jep investitorëve të vet ose të një shteti të tretë cilido qoftë më i favorshmi prej tyre për investitorin. Pagesat e rezultuara do të jenë lirisht të transferueshme.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një investitori të një Pale, i cili në secilën nga situatat e referuara në këtë paragraf, pëson humbje në territorin e Palës tjetër që rezultojnë nga:

a) konfiskimi i investimit ose i një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e kësaj të fundit; ose

b) shkatërrimi i investimit ose i një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e kësaj të fundit, që nuk është i nevojshëm për situatën, do t'i jepet nga Pala e fundit dëmshpërblimi ose kompensimi i cili në çdo rast do të jetë i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv. Pagesat e rezultuara do të bëhen pa vonesë në monedhë lirisht të konvertueshme dhe lirisht të transferueshme.

Neni 7
Transferimet

1. Çdo Palë do t'ju garantojë investitorëve të Palës tjetër, në përputhje me ligjet dhe rregullat e Palës së parë, transferimin e lirë të të gjitha pagesave dhe detyrimeve fiskale që kanë të bëjnë me investimet e tyre. Këto transferime do të përfshijnë në veçanti, por jo ekskluzivisht:

(a) kapitalin fillestar dhe çdo shtesë në kapital për mirëmbajtjen ose rritjen e një investimi;

(b) të ardhurat nga investimi;

(c) fondet për shlyerjen e huave në lidhje me një investim;

(d) kompensimet që jepen në bazë të neneve 5 dhe 6;

(e) të ardhurat nga shitja ose likujdimi total ose i një pjese të investimit;

(f) të ardhura dhe shpërblime të tjera të personelit të angazhuar nga jashtë në lidhje me një investim;

(g) pagesat që kryhen për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, sipas neneve X dhe XI.

2. Transferimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhen pa vonesë dhe në një monedhë lirisht të transferueshme me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transferimit.

3. Palët do t'iu japin transferimeve që referohen në këtë nen një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që i është dhënë transferimit të pagesave, që rrjedhin nga investimet e bëra nga investitorët e ndonjë shteti të tretë.

Neni 8
Kushtet më favorizuese

Nëse legjislacioni i ndonjërës prej Palëve ose detyrimet që rrjedhin sipas të drejtës ndërkombëtare ekzistuese ose të vendosur më vonë midis Palëve si plotësim i kësaj Marrëveshjeje, përmbajnë një rregullim, qoftë ky i përgjithshëm ose i veçantë, që i jep investitorëve të Palës tjetër një trajtim më të favorshëm sesa ai i dhënë nga kjo Marrëveshje, ky rregullim do të jetë mbizotërues për aq sa ai është më i favorshëm kundrejt kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9
Subrogimi

1. Nëse një Palë ose Agjencia e përcaktuar prej saj bën një pagesë për një zhdëmtim, garanci ose kontratë sigurimi kundrejt një risku jotregtar në lidhje me një investim të bërë nga ndonjë prej investitorëve të saj në territorin e Palës tjetër, Pala e fundit do të njohë kalimin e çdo të drejte ose detyrimi të këtij investitori tek ish Pala apo Agjencia e përcaktuar prej saj, që të ushtrojë në bazë të zëvendësimit me të drejta të plota, çdo të drejtë në të njëjtën masë sa edhe paraardhësi i tij.

2. Ky zëvendësim me të drejta të plota do të bëjë të mundur që ish Pala ose Agjencia e përcaktuar prej saj të jetë direkt përfituese e çdo pagese për dëmshpërblim apo kompensim tjetër, që mund të ngarkohet të kryejë investitori.

3. Subrogimi i të drejtave dhe detyrimeve për dëmshpërblimin e investimit do të aplikohet gjithashtu në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis Palëve

1. Çdo mosmarrëveshje midis Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për sa është e mundur, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk është e mundur të zgjidhet brenda 6 (gjashtë) muajve prej fillimit të bisedimeve, ajo do t'i nënshtrohet me kërkesën e njërës prej dy Palëve, një gjykate arbitrazhi.

3. Gjykata e arbitrazhit do të krijohet në mënyrën e mëposhtme: çdo Palë do të emërojë një gjykatës dhe këta gjykatës do të zgjedhin një shtetas të një shteti të tretë si president. Gjykatësit do të zgjidhen brenda tre muajve dhe presidenti brenda pesë muajve, nga data kur secila Palë njofton tjetrën për dëshirën e saj që t'ja nënshtrojë mosmarrëveshjen gjykatës së arbitrazhit.

4. Në rast se brenda afateve të specifikuara në paragrafin (3) të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila Palë, në mungesë të ndonjë marrëveshjeje tjetër, mund të ftojë presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Presidenti është shtetas i ndonjërës prej Palëve, ose në qoftë se ai ndalohet të kryejë funksionet e mësipërme, Zëvendëspresidenti ftohet që të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Zëvendëspresidenti gjithashtu është shtetas i njërës prej Palëve ose nëse ai ndalohet të kryejë funksionet e mësipërme, anëtari më i vjetër i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i cili nuk është shtetas i njërës prej Palëve do të ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Gjykata do t'i nxjerrë vendimet e saja në bazë të respektimit të ligjit kombëtar dhe rregullave që përmban kjo Marrëveshje si dhe parimeve universale të së drejtës ndërkombëtare.

6. Gjykata e arbitrazhit i përcakton vetë procedurat.

7. Gjykata e arbitrazhit do t'i marrë vendimet me shumicë votash dhe ky vendim do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët.

8. Çdo Palë do të përballojë shpenzimet për gjykatësin e zgjedhur prej tij dhe ato të përfaqësimit në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e tjera përfshirë dhe ato të presidentit do të përballohen në pjesë të barabarta nga të dyja Palët.

Neni 11

Mosmarrëveshjet midis njërës Palë dhe një investitori të Palës tjetër

1. Mosmarrëveshjet që mund të ngrihen midis njërës Palë dhe një investitori të Palës tjetër në lidhje me një investim, do të paraqiten me shkrim, përfshi dhe një informacion të detajuar, nga investitori tek Pala pritëse e investimit. Përsa të jetë e mundur, Palët e interesuara do të përpiqen ta zgjidhin këtë mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

2. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda gjashtë muajve nga data kur njoftimi me shkrim referuar paragrafit 1 është shtruar për zgjidhje, mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet, sipas zgjedhjes së investitorit:

a) gjykatës kompetente të Palës në territorin e së cilës investimi është kryer;

b) një gjykate arbitrazhi të përkohshme të krijuar sipas Rregullave të Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Tregtar Ndërkombëtar (UNCITRAL);

c) Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) të krijuar nga "Konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera", e hapur për nënshkrim në Washington në 18 mars 1965, në rastin kur të dy Palët janë anëtare të kësaj Konvente.

3. Arbitrimi do të bazohet në:

- dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
- rregullat dhe parimet universale të së drejtës ndërkombëtare;

- ligji kombëtar i Palës në territorin e së cilës është bërë investimi.

4. Një Palë nuk do të shfrytëzojë për mbrojtje, dëmshpërblim ose kompensim tjetër për të gjitha ose një pjesë të dëmit të pësuar që është marrë ose do të merret nga investitori në bazë të një kontrate garancie ose sigurimi.

5. Vendimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për Palët në mosmarrëveshje. Secila Palë merr përsipër që të zbatojë vendimet në përputhje me legjislacionin e vendit të saj.

Neni 12

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët do të njoftojnë njëra- tjetrën se formalitetet kushtetuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të një Marrëveshje Ndërkombëtare janë përfunduar. Ajo do të jetë në fuqi për një periudhë dhjetë vjeçare, dhe do të rinovohet në mënyrë të heshtur, për një periudhë dy vjeçare në vazhdim.

2. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje me një njoftim me shkrim, adresuar Palës gjashtë muaj përpara datës së përfundimit të saj.

3. Për investimet e bëra para datës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e të gjitha neneve të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi për një periudhë të mëtejshme prej dhjetë vjetësh nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Dëshmojmë se kjo Marrëveshje është nënshkruar me plotfuqishmëri respektive.

Bërë në Beograd, më 26.11.2002 në dy origjinale në gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht duke qenë të gjitha tekstet me fuqi të barabartë.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

V E N D I M
Nr. 52, datë 23.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë (më poshtë referuar si Palët):

Duke dëshiruar të lehtësojnë, në mënyrë të ndërsjellë, hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të

tyre,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

1. Shtetasit e shtetit të secilës Palë, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë, dalin dhe të kalojnë transit nëpër territorin e shtetit të Palës tjetër pa viza.

2. Koha e qëndrimit pa viza e shtetasve të Palës tjetër në territorin e shtetit të Palës tjetër nuk duhet të jetë më tepër se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e hyrjes.

Neni 2

Shtetasit e vendit të Palës tjetër, të cilët janë anëtarë të përfaqësive diplomatike, misioneve konsullore ose organizatave ndërkombëtare, të akredituara në vendin e Palës tjetër, si edhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e vendit të Palës tjetër pa viza.

Neni 3

Shtetasit e vendit të Palës tjetër, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit duhet të hyjnë dhe të dalin nga territori i vendit të Palës tjetër nëpërmjet pikave kufitare të kontrollit, të hapura për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve.

Neni 4

1. Kjo Marrëveshje nuk i përjashton shtetasit e vendeve të të dy Palëve, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit të Palës tjetër.

2. Secila Palë ka të drejtë të refuzojë hyrjen, ose të shkurtojë kohën e qëndrimit të qytetarëve të vendit të Palës tjetër pa e motivuar vendimin e saj.

Neni 5

1. Secila Palë mundet, që për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik, ose shëndetit, të pezullojë të gjithë, ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala që vendos këto masa do të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë, pas marrjes së këtyre masave, nëpërmjet kanaleve diplomatike Palën tjetër, për vendosjen, si dhe për heqjen e tyre.

Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

2. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të këtyre pasaportave 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit një Palë njofton Palën tjetër për përmbushjen e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar dhe do të qëndrojë në fuqi, deri kur njëra nga Palët të njoftojë me shkrim Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike, për denoncimin e saj. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë në ditën e 90-të (nëntëdhjetë) pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Porto/Portugali, më 6.12.2002 në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, moldave

dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë të barazvlefshme. Në rast kontradiktash, mbi interpretimin e këtyre dispozitave, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

V E N D I M
Nr. 53, datë 23.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, për bashkëpunimin në fushën e turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË ITALISË MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E TURIZMIT

Qeveria e Republikës së Italisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese":

Duke njohur rëndësinë e turizmit si për ekonominë e të dyja vendeve ashtu edhe për një mirëkuptim dhe miqësi më të madhe për të dy popujt;

Të bindur për nevojën e promovimit të një bashkëpunimi aktiv në fushën e turizmit, duke pasur parasysh potencialet respektive;

Duke konsideruar interesin që i japin të dyja Palët bashkëpunimit në kuadrin e iniciativës së Adriatikut dhe Jonit;

Duke konsideruar vullnetin e të dy Palëve për të ndërmarrë çdo veprim që ka si qëllim një zhvillim të qëndrueshëm dhe bashkëkohor të turizmit, në përputhje me parimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së burimeve natyrore mjedisore dhe kulturore,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të inkurajojnë zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve turistike ndërmjet dy vendeve me qëllim përmirësimin e njohjes reciproke të historisë dhe kulturës së popujve të tyre dhe do të angazhohen për lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërive, organizatave, institucioneve dhe enteve kompetente të sektorit të turizmit të të dy vendeve.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të impenjohen në promovimin e zhvillimit të turizmit etik dhe të qëndrueshëm, me qëllim rritjen e përfitimeve që rrjedhin nga turizmi për komunitetet lokale dhe mbajtjen e integritetit mjedisor dhe kulturor të tyre.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të inkurajojnë, me qëllim promovimin e flukseve turistike, studimin dhe realizimin e projekteve për përmirësimin nga këndvështrimi sasior dhe cilësor të lidhjeve detare, ajrore dhe tokësore ndërmjet dy vendeve.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të favorizojnë zhvillimin e sektorit turistik duke inkurajuar dhe shkëmbimin e ekspertëve për promovimin e sektorit dhe duke bashkëpunuar në fushën e formimit dhe kërkimit me qëllim një ruajtje dhe menaxhim më të mirë të hapësirave dhe të zhvillimit të investimeve turistike, duke respektuar ligjet dhe normat në fuqi. Bashkëpunimi i sipërpërmendur do të kryhet edhe nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, të studimeve dhe programeve të mësimit në lëndën turistike – hoteliere.

Neni 5

Palët Kontraktuese do të favorizojnë, në masën e mundshme dhe brenda mundësive respektive, shkëmbimin e bursave të studimit për formimin e ekspertëve në menaxhimin e shoqërive turistike dhe të stazheve në sektorin turistik, sipas procedurave që do të vendosen nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Neni 6

Palët Kontraktuese do të favorizojnë për sa të jetë e mundur:

a) realizimin e misioneve teknike në fushën e promocionit dhe guidave turistike, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave respektive dhe studimin e mundësive për realizimin e veprimeve të përbashkëta në promovimin e turizmit;

b) shkëmbimin e publikimeve dhe të materialeve promocionale turistike;

c) krijimin e zyrave përfaqësuese dhe të promovimit turistik në vendet respektive (personeli i këtyre zërave do të veprojë në përputhje me ligjet kombëtare për hyrjen dhe qëndrimin);

d) zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së ndërtesave historike për qëllime turistike;

e) harmonizimin normave respektive në fushën e turizmit si dhe të standardeve dhe angazhimeve në fushën e mjedisit;

f) përdorimi i rrjetit internet si mjet për promovimin turistik dhe për të favorizuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet dy vendeve.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të favorizojnë promovimin e udhëtimeve kolektive në rastet e panaireve, kongreseve, manifestimeve kulturore e sportive dhe do të favorizojnë udhëtimet të cilat zhvillojnë turizmin social, duke krijuar reciprokisht lehtësirat më të mëdha.

Neni 8

Palët Kontraktuese do të mundohen, duke respektuar legjislacionet respektive, të lehtësojnë dhe thjeshtojnë, për sa të jetë e mundur, formalitetet e aplikimit për hyrjen dhe rihyrjen e turistëve të të dyja vendeve, si dhe të importit dhe eksportit të dokumenteve dhe materialeve të promovimit turistik.

Neni 9

Palët Kontraktuese, duke respektuar legjislacionin e tyre, do të favorizojnë dhe inkurajojnë aktivitetet e ofruesve të shërbimeve turistike, si agjenci udhëtimi, operatorë turistikë, rrjeteve hoteliere, shoqërive ajrore, hekurudhore, operatorëve të linjave tokësore dhe detare, me qëllim rritjen e flukseve

turistike drejt të dyja vendeve.

Neni 10

Palët Kontraktuese do të favorizojnë adaptimin e çdo mase të nevojshme administrative, financiare dhe fiskale për lehtësimin e investimeve reciproke dhe mbi të gjitha nëpërmjet krijimit të shoqërive të përbashkëta ("Joint – Ventures") me qëllim zgjerimin e infrastrukturave respektive turistike dhe për të kontribuar në rritjen dhe rregullimin e flukseve turistike ndërmjet dy vendeve.

Palët Kontraktuese do të favorizojnë krijimin e rrugëve të informacionit në fushën e turizmit, eventualisht edhe duke krijuar një data-base të vendit tjetër, për mundësinë e investimit në sektorin turistik, edhe nëpërmjet individualizmit të projekteve, shkëmbimin e ekspertëve dhe organizimin e seminareve dhe vizitave për konsulentë dhe sipërmarrës.

Neni 11

Palët Kontraktuese do të favorizojnë zhvillimin e bashkëpunimit edhe në kuadrin e Organizatave Ndërkombëtare që veprojnë në fushën e turizmit, në kuadër të Iniciativës së Europës Qendrore dhe Iniciativës së Jonit dhe Adriatikut, duke bashkëpunuar me vendet e tjera anëtare dhe do të shkëmbejnë informacion mbi rezultatet e arritura nga secili vend në këtë fushë.

Neni 12

Pala italiane, sipas kërkesës, do të japë konsulencën e saj në formën e kërkuar nga Pala shqiptare, konkretisht për ndërtimin e një sistemi turistik shqiptar, në përputhje me të veçantat e Kombit shqiptar, të historisë dhe traditës së tij.

Neni 13

Për vënien në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të formojnë një Komision të Përbashkët, i ngarkuar të ndihmojë zbatimin e Marrëveshjes, të koordinojë programet ekzekutivë dhe të kontrollojë zbatimin e tyre.

Komisioni, i përbërë në mënyrë të barabartë nga përfaqësues të administratave kompetente të turizmit të të dy vendeve, do të mblidhet në data që do të përcaktohen, në mënyrë të alternuar në Itali dhe Shqipëri.

Neni 14

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk paragjykojnë të drejtat dhe detyrat e Palëve Kontraktuese në lidhje me Konventa Ndërkombëtare të lidhura prej tyre me vende të tjera.

Mospërputhjet e mundshme në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen në rrugë diplomatike nëpërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 15

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me anë të të cilit Palët Kontraktuese informohen reciprokisht për përfundimin e procedurave të brendshme, përkatëse për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 16

Kjo Marrëveshje do të ketë një kohë zgjatje prej pesë vjetësh dhe do të zgjatet nga viti në vit, përveç, në rastin e denoncimit të saj. Secila nga Palët Kontraktuese mund të denoncojë Marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet rrugëve diplomatike. Denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas njoftimit të Palës tjetër Kontraktuese dhe nuk do të ndikojë në realizimin e projekteve për zbatimin e të cilave është rënë dakord, gjatë periudhës që Marrëveshja ka qenë në fuqi, përveç kur Palët bien dakord

ndryshe.

Me besim në të, përfaqësuesit e mëposhtëm, të autorizuar nga qeveritë respektive, kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 23.10.2002, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe dhe italiane, të dyja tekstet me fuqi të barabartë.

V E N D I M
Nr. 59, datë 23.1.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 415, DATË 1.7.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT "PËR MUNDËSI TË BARABARTA", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.127, DATË 15.3.2001"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr. 8485, dsatë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 415, datë 1.7.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

"1. Komiteti "Për mundësi të barabarta" është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, që funksionon sipas rregullores së brendshme, të miratuar nga Ministri.".

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"3. Kryetari i komitetit "Për mundësi të barabarta", emërohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, ndërsa struktura dhe organika e komitetit caktohen nga Kryeministri.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 60, datë 23.1.2003

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 372, DATË 25.7.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ADMINISTRIMIN E MALLRAVE REZERVË SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8576, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 372, datë 25.7.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Mallrat rezervë shtetërore administrohen nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore, si institucion që varet drejtpërdrejtë prej tij dhe grupohen në mallra rezervë shtetërore të paprekshme, të grupit A, dhe mallra rezervë shtetërore operative, të grupit B.".

b) Pika 9 ndryshon si më poshtë vijon:

"9. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore ka për detyrë drejtimin ekonomiko-

financiar dhe tekniko-organizativ të degëve të rezervës shtetërore, të ushtrojë kontroll mbi veprimtaritë e tyre dhe përgjigjet para Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit për të gjithë veprimtarinë e sektorit të rezervave shtetëtore.".

c) Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1. Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përgatisë rishikimin e misionit, të mënyrës së funksionimit dhe organizimit në tërësi të sistemit të rezervave shtetërore dhe të paraqesë për miratim projektaktet e nevojshme.".

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 61, datë 23.1.2003

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE DHE TË PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Për Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës të jenë si më poshtë vijon:

I. Përfaqësues nga organizatat e punëmarrësve:

a) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)	5 anëtarë, 5 kandidatë;
b) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH)	4 anëtarë, 4 kandidatë;
c) Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH)	1 anëtar, 1 kandidat.

II. Përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve:

a) Konfederata e Punëdhënësve të Shqipërisë (KOP)	4 anëtarë, 4 kandidatë;
b) Bashkimi i Organizatave të Biznesit Shqiptar (BOBSH)	3 anëtarë, 3 kandidatë;
c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH)	1 anëtar, 1 kandidat;
ç) Bashkimi i Industrialistëve dhe Investitorëve të Shqipërisë (BI&Ish)	1 anëtar, 1 kandidat;
d) Këshilli i Agrobiznesit shqiptar	1 anëtar, 1 kandidat.

2. Emërtimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me propozimin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve.

3. Vendimi nr. 768, datë 8.12.1998 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës", i ndryshuar me vendimin nr. 307, datë 1.7.1999 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

NUMRI I PUNONJËSVE TË SEKSIONEVE TË ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS

N/P	Emërtimi i Qarkut	Numri i punonjësve	Nëndarja administrative	Numri i punonjësve
1	BERAT	8	Berat Kuçovë Skrapar	4 2 2
2	FIER	12	Fier Lushnjë Mallakastër	5 4 3
3	GJIROKASTËR	8	Gjirokastër Përmet Tepelenë	4 2 2
4	DIBËR	7	Peshkopi Bulqizë Mat	3 2 2
5	KUKËS	7	Kukës Has Tropojë	3 2 2
6	LEZHË	7	Lezhë Kurbin Mirditë	3 2 2
7	SHKODËR	8	Shkodër M.Madhe Pukë	4 2 2
8	VLORË	10	Vlorë Delvinë Sarandë	5 2 3
9	DURRËS	7	Durrës Krujë	4 3
10	TIRANË	7	Tiranë Kavajë	4 3
11	KORÇË	11	Korçë Devoll Kolonjë Pogradec	4 2 2 3
12	ELBASAN	10	Elbasan Peqin Gramsh Librazhd	4 2 2 2
	Totali	102		102

V E N D I M
Nr. 62, datë 23.1.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" DHE LIGJIT NR. 7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 458, DATË 28.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhet ky ndryshim:

Paragrafi i parë i pikës 6, të kapitullit III, të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 5 215 (pesë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë, me përjashtim të atyre që jetojnë në rrethet: Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor të jetë 3 592 (tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 63, datë 23.1.2003

PËR NUMRIN E PUNONJËSVE, STRUKTURËN DHE ORGANIKËN E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 58 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Shërbimit të Gjendjes Civile, në bashki e komuna, është 506 veta.

2. Struktura e Shërbimit të Gjendjes Civile është sipas skemës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Organika e zyrave të Gjendjes Civile, në bashki e komuna, është sipas skemës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, dhe fillojnë në 1.1.2003.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Skema 1



Skema nr. 2

Organika e zyrave të gjendjes civile në bashki e komuna

Nr.	Qarku	Zyra të Gj.C. në Bashki	Nr.i punonjësve në Z.Gj.C.në Bashki	Zyra të Gj.C. në Komuna	Nr.i punonjësve në Z.Gj.C.në komuna
1	Berat	7	11	20	20
2	Dibër	4	7	31	31
3	Durrës	10	18	10	10
4	Elbasan	11	17	43	43
5	Fier	10	18	36	36
6	Gjirokastër	6	8	26	26
7	Korçë	9	15	31	31
8	Kukës	3	6	24	24
9	Lezhë	5	9	16	16
10	Shkodër	8	15	29	30
11	Tiranë	15	52	24	24
12	Vlorë	11	19	19	20
Totali		99	192	309	311

Numri i zyrave të Gjendjes Civile në bashki e komuna408
Numri i punonjësve në bashki e komuna 606

Qarku Berat

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Berat				
2		Berat		3	6
3		U.Vajgurore		1	1
4			Kutalli	1	1
5			Lumas	1	1
6			Otllak	1	1
7			Poshnje	1	1
8			Roshnik	1	1
9			Sinje	1	1
10			Terpan	1	1
11			Velabisht	1	1
12			Vertop	1	1
13			Cukalat	1	1
1	Kuçovë				
2		Kuçovë		1	2
3			Kozarë	1	1
4			Perondi	1	1
1	Skrapar				
2		Çorovodë		1	1
3		Poliçan		1	1
4			Bogovë	1	1
5			Cepan	1	1
6			Gjerbes	1	1

7			Leshnjë	1	1
8			Potom	1	1
9			Qendër	1	1
10			Vendreshë	1	1
11			Zhepe	1	1
Tot	3	5	20	27	31

Punonjës të gjendjes civile në bashki 11
Punonjës të gjendjes civile në komuna 20

Qarku Dibër

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Dibër				
2		Peshkopi		1	2
3			Arras	1	1
4			Fushë Çidhën	1	1
5			Fushë Muhur	1	1
6			Kala e Dodës	1	1
7			Kastriot	1	1
8			Lurë	1	1
9			Luzni	1	1
10			Maqellarë	1	1
11			Melan	1	1
12			Tomin	1	1
13			Selishtë	1	1
14			Sllovë	1	1
15			Zall Dardhë	1	1
16			Zall Reç	1	1
1	Mat				
2		Burrel		1	2
3		Klos		1	1
4			Derjan	1	1
5			Gurrë	1	1
6			Baz	1	1
7			Komsi	1	1
8			Lis	1	1
9			Macukull	1	1
10			Rukaj	1	1
11			Suç	1	1
12			Ulëz	1	1
13			Xibër	1	1
1	Bulqizë				
2		Bulqizë		1	2
3			Gjoricë	1	1
4			Klenjë	1	1
5			Martanesh	1	1
6			Ostren	1	1
7			Shupenzë	1	1

8			Zerqan	1	1
9			Fushë Bulqizë	1	1
Tot	3	4	31	35	38

Punonjës të gjendjes civile në bashki7
Punonjës të gjendjes civile në komuna31

Qarku Durrës

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Durrës				
2		Durrës		5	11
3		Manëz		1	1
4		Sukth		1	1
5		Shijak		1	2
6			Gjepalaj	1	1
7			Ishëm	1	1
8			Katund i ri	1	1
9			Maminas	1	1
10			Rashbull	1	1
11			Qafzotaj	1	1
1	Krujë				
2		Krujë		1	1
3		Fushë-Krujë		1	2
4			Bubq	1	1
5			Cudhi	1	1
6			K.Thumanë	1	1
7			Nikël	1	1
Tot	2	6	10	20	28

Punonjës të gjendjes civile në bashki18
Punonjës të gjendjes civile në komuna10

Qarku Elbasan

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Elbasan				
2		Elbasan		5	10
3		Cërrik		1	1
4		Belsh		1	1
5			Bradashesh	1	1
6			Fierzë	1	1
7			Funarë	1	1
8			Gostimë	1	1
9			Gracen	1	1
10			Grekan	1	1
11			Gjinar	1	1
12			Gjergjan	1	1
13			Kajan	1	1
14			Klos	1	1

15			Labinot mal	1	1
16			Labinot fushë	1	1
17			Mollas	1	1
18			Paper	1	1
19			Rrasë	1	1
20			Shalës	1	1
21			Shirgjan	1	1
22			Shushicë	1	1
23			Tregan	1	1
24			Zavalin	1	1
1	Gramsh				
2		Gramsh		1	2
3			Kodovjat	1	1
4			Kukur	1	1
5			Kushovë	1	1
6			Lenie	1	1
7			Pishaj	1	1
8			Poroçan	1	1
9			Skënderbegas	1	1
10			Sult	1	1
11			Tunjë	1	1
1	Peqin				
2		Peqin		1	1
3			Karinë	1	1
4			Gjocaj	1	1
5			Pajovë	1	1
6			Përparim	1	1
7			Shezë	1	1
1	Librazhd				
2		Librazhd		1	1
3		Prrenjas		1	1
4			Hotolisht	1	1
5			Lunik	1	1
6			Orenjë	1	1
7			Poli s	1	1
8			Qendër	1	1
9			Qukës	1	1
10			Rajcë	1	1
11			Stravaj	1	1
12			Steblevë	1	1
Tot	4	7	43	54	60

Punonjës të gjendjes civile në bashki17
Punonjës të gjendjes civile në komuna43

Qarku Fier

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.

1	Fier				
2		Fier		4	9
3		Patos		1	2
4		Roskovec		1	1
5			Cakran	1	1
6			Dermenas	1	1
7			Frakull	1	1
8			Kuman	1	1
9			Kurjan	1	1
10			Libofshë	1	1
11			Levan	1	1
12			Mbrostar	1	1
13			Portez	1	1
14			Qendër	1	1
15			Ruzhdie	1	1
16			Strum	1	1
17			Topojë	1	1
18			Zharrës	1	1
1	Lushnjë				
2		Lushnjë		2	4
3		Divjakë		1	1
4			Allkaj	1	1
5			Ballagat	1	1
6			Bubullimë	1	1
7			Dushk	1	1
8			Fier Shegan	1	1
9			Golem	1	1
10			Grabian	1	1
11			Gradisht	1	1
12			Hysgjokaj	1	1
13			Karbunarë	1	1
14			Kolonjë	1	1
15			Krutje	1	1
16			Remas	1	1
17			Tërbuf	1	1
1	Mallakastër				
2		Ballsh		1	1
3			Aranitas	1	1
4			Fratar	1	1
5			Greshicë	1	1
6			Hekal	1	1
7			Kute	1	1
8			Ngracan	1	1
9			Qendër	1	1
10			Selitë	1	1
Tot	3	6	36	46	54

Punonjës të gjendjes civile në bashki18
Punonjës të gjendjes civile në komuna36

Qarku Gjirokastër

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Gjirokastër				
2		Gjirokastër		1	3
3		Libohovë		1	1
4			Qendër	1	1
5			Cepo	1	1
6			Dropull posht.	1	1
7			Dropull sip.	1	1
8			Lazarat	1	1
9			Lunxheri	1	1
10			Odrie	1	1
11			Picar	1	1
12			Pogon	1	1
13			Antigon	1	1
14			Zagori	1	1
1	Tepelenë				
2		Tepelenë		1	1
3		Memaliaj		1	1
4			Buz	1	1
5			F.Memaliaj	1	1
6			Krahës	1	1
7			Kurvelesh	1	1
8			Lopës	1	1
9			Luftinjë	1	1
10			Qesarat	1	1
11			Qendër	1	1
1	Përmet				
2		Përmet		1	1
3		Këlcyrë		1	1
4			Ballaban	1	1
5			Çarçovë	1	1
6			Frashër	1	1
7			Petran	1	1
8			Qendër	1	1
9			Sukë	1	1
10			Dishnicë	1	1
Tot	3	6	26	32	34

Punonjës të gjendjes civile në bashki8
Punonjës të gjendjes civile në komuna26

Qarku Korçë

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Korçë				
2		Korçë		4	7

3		Maliq		1	1
4			Drenovë	1	1
5			Gore	1	1
6			Lekas	1	1
7			Linobik	1	1
8			Liqenas	1	1
9			Moglicë	1	1
10			Mollaj	1	1
11			Pirg	1	1
12			Pojan	1	1
13			Qendër	1	1
14			Vithkuq	1	1
15			Voskop	1	1
16			Voskopojë	1	1
17			Vreshtas	1	1
1	Kolonjë				
2		Ersekë		1	1
3		Leskovik		1	1
4			Barmash	1	1
5			Çlirim	1	1
6			Leskovik	1	1
7			Mollas	1	1
8			Novoselë	1	1
9			Qendër Ersekë	1	1
1	Pogradec				
2		Pogradec		1	3
3			Buçimas	1	1
4			Çërravë	1	1
5			Dardhas	1	1
6			Udenisht	1	1
7			Proptisht	1	1
8			Trebinjë	1	1
9			Velçan	1	1
1	Devoll				
2		Bilisht		1	2
3			Qendër Bilisht	1	1
4			Miras	1	1
5			Hoçisht	1	1
6			Progër	1	1
Tot	4	6	31	40	46

Punonjës të gjendjes civile në bashki15
Punonjës të gjendjes civile në komuna31

Qarku Kukës

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Kukës				
2		Kukës		1	3

3			Arren	1	1
4			Bicaj	1	1
5			Bushtricë	1	1
6			Malzi	1	1
7			Ujmisht	1	1
8			Tërthore	1	1
9			Shtiqën	1	1
10			Zapod	1	1
11			Shishtavec	1	1
12			Topojan	1	1
13			Surroj	1	1
14			Kolsh	1	1
15			Kalis	1	1
16			Grykë Çajë	1	1
1	Has				
2		Krumë		1	1
3			Golaj	1	1
4			Fajzë	1	1
5			Gjinaj	1	1
1	Tropojë				
2		B.Curri		1	2
3			Bujan	1	1
4			Bytyç	1	1
5			Fierzë	1	1
6			Lekbibaj	1	1
7			Llugaj	1	1
8			Margegaj	1	1
9			Tropojë	1	1
Tot	3	3	24	27	30

Punonjës të gjendjes civile në bashki6
Punonjës të gjendjes civile në komuna24

QARKU LEZHË

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Lezhë				
2		Lezhë		1	2
3			Balldre	1	1
4			Blinisht	1	1
5			Dajç	1	1
6			Kallmet	1	1
7			Kolsh	1	1
8			Shëngjin	1	1
9			Ungrej	1	1
10			Shënkoll	1	1
11			Zejmen	1	1
1	Mirditë				
2		Rrëshen		1	2

3		Rubik		1	1
4			Fan	1	1
5			Kaçinar	1	1
6			Kthellë	1	1
7			Orosh	1	1
8			Selitë	1	1
1	Kurbin				
2		Laç		1	2
3		Mamuras		1	2
4			Fushë Kuqe	1	1
5			Milot	1	1
Tot	3	5	16	21	25

Punonjës të gjendjes civile në bashki9
Punonjës të gjendjes civile në komuna 16

Qarku Shkodër

Nr	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Shkodër				
2		Shkodër		4	10
3		Vau Dejës		1	2
4			Ana Malit	1	1
5			Barbullush	1	1
6			Bushat	1	1
7			Bërdicë	1	1
8			Dajç	1	1
9			Gur i Zi	1	1
10			Hajmel	1	1
11			Postribë	1	1
12			Pult	1	1
13			Rrethinat	1	1
14			Shalë	1	1
15			Shosh	1	1
16			Temal	1	1
17			Velipojë	1	1
18			Vig Mnelë	1	1
19			Shllak	1	1
1	Pukë				
2		Pukë		1	1
3		Fushë Arrëz		1	1
4			Blerim	1	1
5			Iballë	1	1
6			Fierzë	1	1
7			Gjegjan	1	1
8			Qafë Mali	1	1
9			Qelëz	1	1
10			Qerret	1	1
11			Rrape	1	1

1	M.Madhe				
2		Koplik		1	1
3			Gruemirë	1	1
4			Kastrat	1	2
5			Kelmend	1	1
6			Qendër	1	1
7			Shkrel	1	1
Tot	3	5	29	37	45

Punonjës të gjendjes civile në bashki15
Punonjës të gjendjes civile në komuna30

Qarku Tiranë

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Tiranë				
2		Tiranë		11	44
3		Kamëz		1	3
4		Vorë		1	1
5			Baldushk	1	1
6			Bërzhitë	1	1
7			Bërxull	1	1
8			Dajt	1	1
9			Farkë	1	1
10			Kashar	1	1
11			Ndroq	1	1
12			Paskuqan	1	1
13			Petrelë	1	1
14			Pezë	1	1
15			Prezë	1	1
16			Shëngjergj	1	1
17			Vaqarr	1	1
18			Zall Bastar	1	1
19			Zall Herr	1	1
20			Krrabë	1	1
1	Kavajë			1	3
2		Kavajë		1	1
3		Rrogozhinë		1	1
4			Golem	1	1
5			Gosë	1	1
6			Helmës	1	1
7			Kryevidh	1	1
8			Lekaj	1	1
9			Luz i Vogël	1	1
10			Sinaballaj	1	1
11			Synej	1	1
Tot	2	5	24		76

Punonjës të gjendjes civile në bashki52
Punonjës të gjendjes civile në komuna24

Bashkia Tiranë

Nr.	BASHKIA	NJËSITË BASHKIAKE	ZYRA E GJ.C.	PUNONJËS GJ.C.
1	Tiranë		1	3
2		Nr.1	1	4
3		Nr.2	1	4
4		Nr.3	1	3
5		Nr.4	1	4
6		Nr.5	1	4
7		Nr.6	1	4
8		Nr.7	1	4
9		Nr.8	1	3
10		Nr.9	1	4
11		Nr.10	1	3
12		Nr.11	1	4
Tot	1	11	12	44

Numri i zyrave të gjendjes civile12
Numri i punonjësve të gjendjes civile44

Qarku Vlorë

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Gj.C.	Punonjës Gj.C.
1	Vlorë				
2		Vlorë		5	10
3		Himarë		1	1
4		Orikum		1	1
5		Selenicë		1	1
6			Armen	1	1
7			Brataj	1	1
8			Horë Vranisht	1	1
9			Kotë	1	1
10			Novoselë	1	2
11			Qendër	1	1
12			Sevaster	1	1
13			Shushicë	1	1
14			Vllahinë	1	1
1	Sarandë				
2		Sarandë		1	3
3		Konispol		1	1
4			Aliko	1	1
5			Dhiver	1	1
6			Ksamil	1	1
7			Livadhja	1	1
8			Lukovë	1	1
9			Markat	1	1
10			Xarrë	1	1

1	Delvinë				
2		Delvinë		1	2
3			Finiq	1	1
4			Mesopotam	1	1
5			Vergo	1	1
Tot	3	7	19	30	39

Punonjës të gjendjes civile në bashki19
Punonjës të gjendjes civile në komuna20

V E N D I M
Nr. 64, datë 23.1.2003

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË SEKSIONEVE TË ADMINISTRIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKËS, NË KËSHILLAT E QARQEVE DHE TË ZYRAVE TË MENAXHIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKËS, NË KOMUNA DHE/OSE BASHKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, të kenë në përbërje të tyre numrin e punonjësve, të përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë komunave dhe/ose bashkive, të kenë në përbërje një numër punonjësish, të përcaktuar me vendim të këshillit të komunës dhe/ose bashkisë, në varësi të sipërfaqes së tokës dhe të kushteve të territorit.

3. Në konkurrimin dhe emërimin e përgjegjësit dhe të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës pranohen dhe caktohen në detyrë vetëm specialistë me profesion agronom, gjeodet, gjeograf dhe ekonomist.

4. Plotësimi i numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të bëhet brenda organikës vjetore të numrit të punonjësve të këshillave të qarqeve.

5. Punonjësit e strukturave të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të paguhen sipas vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

6. Fondi i pagës së punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të përfshihet në buxhetin vjetor të këshillave të qarqeve, në fondin e kushtëzuar.

7. Fondi i pagës së punonjësve të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë komunave dhe/ose bashkive, të përfshihet brenda buzhetit vjetor të tyre, nga granti.

8. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.1.2003.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Numri i punonjësve të seksioneve administrimit dhe mbrojtjes së tokës

N/P	Emërtimi i Qarkut	Numri i punonjësve	Nëndarja administrative	Numri i punonjësve
1	BERAT	8	Berat Kuçovë Skrapar	4 2 2
2	FIER	12	Fier Lushnjë Mallakastër	5 4 3
3	GJIROKASTËR	8	Gjirokastër Përmet Tepelenë	4 2 2
4	DIBËR	7	Peshkopi Bulqizë Mat	3 2 2
5	KUKËS	7	Kukës Has Tropojë	3 2 2
6	LEZHË	7	Lezhë Kurbin Mirditë	3 2 2
7	SHKODËR	8	Shkodër M.Madhe Pukë	4 2 2
8	VLORË	10	Vlorë Delvinë Sarandë	5 2 3
9	DURRËS	7	Durrës Krujë	4 3
10	TIRANË	7	Tiranë Kavajë	4 3
11	KORÇË	11	Korçë Devoll Kolonjë Pogradec	4 2 2 3
12	ELBASAN	10	Elbasan Peqin Gramsh Librazhd	4 2 2 2
	Totali	102		102

V E N D I M
Nr. 131, datë 29.1.2003

MBI HEQJEN DHE REDUKTIMIN E KOHËS SË VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR DISA SUBJEKTE TELEVIZIVE

Në mbështetje të nenit 7/21, nenit 33/5 dhe nenit 137 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të vendimit nr. 125, datë 27.11.2002 të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, ky i fundit

V E N D O S I:

1. T'i heqë licencën subjektit "Radio Jon" (neni 34, pika 5).

2. T’i reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës nga 5 vjet në 4 vjet subjekteve televizive TV ATN 1, TV Alba, TV Drini, TV Kukësi dhe TV Bajram Curri.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Mars, 2002

Kodi i Procedurës Penale

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Shtator, 2002

Kodi i Procedurës Civile

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Korrik, 2002

Kodi Rrugor

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Qershor,2002

Kodi Penal Ushtarak

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

U dorëzua për shtyp më 28.1.2003
Doli nga shtypi më 31.1.2003

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë